



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

**INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION**

RAPORT VJETOR I PUNES

1 janar – 31 dhjetor 2021

Prishtinë

20 prill 2022

Përmbajtja

HYRJE	3
1. KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE E TRAJNIMEVE	4
1.1. Korniza ligjore dhe institucionale për menaxhimin e trajnimit	4
1.2. Korniza strategjike e trajnimit	4
2. ZHVILLIMI PROFESIONAL NË SHËRBIMIN CIVIL	6
2.1. Programi i ofruar i trajnimit	6
2.2. Rezultatet dhe indikatorët e trajnimeve	7
2.3. Përfaqësimi në trajnim	9
3. MËNYRA E OFRIMIT TË TRAJNIMIT DHE DIGJITALIZIMI I TRAJNIMIT	11
3.1. Trajnimet tradicionale dhe trajnimet virtuale	11
3.2. Digjitalizimi i trajnimit	11
4. BASHKËPUNIMI NË SFERËN E TRAJNIMIT	13
4.1. Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë	13
4.2. Bashkëpunimi me institucione	14
5. TRAJNIMET PËR TRAJNER DHE REFORMA E TRAJNERËVE	16
5.1. Angazhimi i trajnerëve në trajnime	16
5.2. Trajnimet për trajnerë	16
5.3. Reformimi i sistemit të trajnimeve për trajnerë	17
6. FINANCIMI I IKAP NË VITIN 2021	18
6.1. Burimet e financimit	18
6.2. Menaxhimi dhe shfrytëzimi mjeteve financiare të IKAP	18
6.2.1. Pagesat për trajnerë	18
6.2.2. Blerjet përmes procedurave të prokurimit publik	19
6.3. FINANCIMI NGA FONDET DONATORE	19
7. ZHVILLIMI ORGANIZATIV	21
7.1. Ristrukturimi institucional i IKAP	21
7.2. Menaxhimi i personelit	21
7.3. Investimet në kushtet për punë dhe në infrastrukturë	22
7.4. Komunikimi dhe informimi	22
8. PRIORITETET PËR VITIN 2022	23
9. PËRFUNDIMI	25

HYRJE

Në këtë raport janë përmbledhur aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2021 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Dy prioritetet aftësimi dhe trajnimi i nëpunësve civil dhe zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të përcaktuara në planin e punës kanë udhëhequr veprimtarinë IKAP gjatë vitit 2021. Viti i kaluar është përshkruar me ngjarje të rëndësishme për IKAP. Në kuadër të reformave të ristrukturimit institucional, Qeveria e Kosovës ka bërë bashkimin e dy ministrive, MPB dhe MAP në një ministri të vetme, në MPB. Pas këtij procesi IKAP është vendosur nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke ruajtur përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L – 211, për Institutin e Administratës Publike.

Efektet e SARS-CoV-2 edhe në vitin 2021 ishin me ndikim të lartë në mënyrën e punës së IKAP si në gjithë vendin. Aktivitetet e IKAP kanë vazhduar pandërprerë, një pjesë e madhe është bërë nga shtëpia, duke mbajtur në punë vetëm stafin esencial. 58% e trajnimeve të planifikuara për vitin 2021 për NC janë ofruar online. Gjithashtu, efektet e pandemisë, përkundër ndikimit negativ, tek IKAP kanë nxitur ridimensionimin dhe avancimin veprimtarisë së trajnimit duke i kushtuar vëmendje ofrimit të trajnimit online.

Në vitin 2021 janë bërë investimet kyçe në kapacitetet e brendshme, është përgatitur projekti i ristrukturimit organizativ dhe është punuar legjislacioni për reformën e trajnerëve. Krahas investimeve me kapacitetet e IKAP ka përfituar nga projektet e organizatave ndërkombëtare përmes të cilave është hartuar Plani afatmesëm i trajnimit të nëpunësve civil për vitin 2022-2024 dhe kanë vazhduar investimet në ndërtimin kapacitetit për ofrimin e trajnimeve në formë digjitale.

Ky raport është strukturuar në 7 pjesë/kapituj:

Pjesa e parë paraqet informacione për kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale për zhvillimin e trajnimeve në SHC; **Pjesa e dytë** përmban informacione për programet dhe indikatorët e trajnimit të zbatuar në mbështetje të zhvillimit të shërbimit civil; **Pjesa e tretë** trajton mënyrat e ofrimit të trajnimit dhe investimet në digjitalizimin trajnimit; **Pjesa e katërt** bashkëpunimin me donatorë dhe institucionet në sferën e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të brendshme; **Pjesa pestë** trajton angazhimin e trajnerëve, trajnimet për trajnerë dhe Reformat e trajnerëve, **Pjesa gjashtë** trajton burimet e financimit dhe menaxhimin e tyre; **Pjesa e shtatë** trajton zhvillimin organizativ.

Raporti po ashtu përmban informacione për mënyrën se si është menaxhuar IKAP, si janë përdorur burimet. Në fund të raportit prezantohen prioritetet dhe sfidat për vitin 2022. Ky raport gjithashtu përmban tabela dhe grafikë përmes të cilëve ofron të dhëna statistikore për indikatorët e trajnimeve të programeve të aftësimi të zbatuara gjatë vitit 2021.

1. KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE E TRAJNIMEVE

Burimet njerëzore janë aseti kyç i administratës publike prej nga varet suksesi i hartimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë dhe institucioneve si njësi të veçanta. Aplikimi i trajnimit në zhvillimin e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike është treguar të jetë mjet i shpejtë dhe i suksesshëm. Megjithatë, trajnimet janë efektive vetëm nëse njohuritë dhe aftësitë që fitohen në ato trajnime ndihmojnë në zbatimin e politikave dhe programeve strategjike të vendit. Duke u bazuar në këtë qasje është hartuar edhe programi i trajnimit për NC për vitin 2021.

1.1. Korniza ligjore dhe institucionale për menaxhimin e trajnimit

Korniza ligjore e cila rregullon tipet e trajnimit, mënyrën e planifikimit dhe zbatimit të trajnimeve dhe të cilës i është kushtuar kujdes në hartimin e programit të trajnimit për vitin 2021 përbëhet nga tre ligje kryesore si në vijim:

- Ligji (06/L– 114) për zyrtarët publikë (LZP) dhe Ligji nr. 04/l -221 për institutin e Kosovës për administratë publike, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet në fushën e trajnimit, tipet e trajnimit. Nga këto dy ligje në programin e trajnimit për vitin 2021 janë përfshirë: (i) trajnimet hyrëse, (ii) trajnimet e vazhdueshme si dhe (iii) trajnimet për trajner ndërsa nuk janë përfshirë: (i) Trajnimet e detyrueshme për ngritje në detyrë, (ii) për drejtues të lartë si dhe (iii) trajnimet për vlerësimin e rezultateve në punë pasi baza ligjore pas baza ligjore për këto tipe të trajnimit nuk është kompletuar.

Tabela 1. Kategoritë e trajnimit sipas LZP	Nenet
1. Programe trajnimit të detyrueshëm gjatë periudhës së provës	37
2. Programe trajnime të specializuara për mbajtjen e standardit profesional	31
3. Programe trajnime bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë	43
4. Programe të detyrueshme për ngritje në karrierë	39
5. Programe trajnime për nivelin drejtues të lartë	42
6. Programe fakultative	12

- Ligji nr. 05/L -068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042, për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 042 për prokurimin publik (LPP), ka përcaktuar programet e detyrueshme për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit publik: (i) programin themelor për prokurim publik i cili zgjat 15 ditë dhe (ii) programin e avancuar për prokurim publik i cili zgjat 10 ditë. Të dy këto programe janë përfshirë në programin e trajnimit për vitin 2021 dhe janë organizuar në trajnime në bashkëpunim me KRPP ashtu siç është përcaktuar në ligj.

1.2. Korniza strategjike e trajnimit

Në programin e trajnimit të realizuara gjatë vitit 2021 janë reflektuar kërkesat e trajnimit që janë vendosur në objektivat e 6 strategjive kyçe funksionale për këtë periudhë kohore:

- Në Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017-2021 (SPPKPK) janë paraparë të organizohen trajnime për (i) planifikimin dhe zbatimin e MSA-së; (ii) sistemit të planifikimit të integruar të politikeve; (III) fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse; (iii) ngritjen e kapaciteteve të administratës për

menaxhimin e ndihmës së jashtme, (iv) trajnimet për monitorim, raportim dhe vlerësim të integruar të politikave. Kjo strategji synon që të përmirësojë sistemin e planifikimit të politikëbërjes në të gjithë administratën publike.

- Ne Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021, janë paraparë të organizohen trajnime për: (i) përmirësimin e hartimit të legjislacionit, (ii) për konsultimet publike për (iv) modelin e kostimit standard, etj. Kjo strategji synon përmirësimin e hartimit të politikave dhe legjislacionit duke u siguruar që ato të jenë të bazuara në dëshmi dhe që i kontribuojnë përmirësimit të qeverisjes së mirë.
- Ne Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) të Kosovës 2016-2020, janë paraparë të organizohen trajnime për: (i) vlerësimin e ndikimit buxhetor, (ii) kontrollin e brendshëm të financave publike, (iii) Sistemin e Zhvillimit për Menaxhimin e Buxhetit, (iv) Programin për investime publike etj. Kjo strategji paraqet planet kryesore Qeverisë së Kosovës për reformë në menaxhimin e procesit të buxhetit, planifikimin, ekzekutimin e tij, kontabilitetin, raportimin, auditimin si dhe mbikëqyrjen.
- Ne Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020, janë paraparë të organizohen trajnime për: (i) menaxhimin e burimeve njerëzore, (ii) aspektet e llogaridhënies dhe (iii) zhvillimit të shërbimeve të cilat janë edhe tre fushat që i promovon kjo strategji e të cilat janë përfshirë në programin e trajnimit për vitin 2021.
- Ne Strategjinë për vetëqeverisje lokale (SVL) 2016 - 2026, janë paraparë të organizohen trajnime për: (i) Planifikim dhe menaxhim për financat lokale; (ii) digjitalizimin e shërbimeve administrative; (iii) hartimin politikave dhe planifikimin strategjik; (iv) Menaxhimin pronës komunale, (v) menaxhimin e projekteve, kontratave, (vi) Komunikim me qytetarët dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike. Kjo strategji synon të rris autonomin lokale dhe aftësinë e Komunave për të arritur përmirësimin e qëndrueshëm dhe për të ofruar shërbime në përshtatshmëri me kërkesat e qytetarëve.
- Strategjia për trajnime të nëpunësve civilë 2016 – 2020, është dokumenti nga i cili derivohen planet dhe programet vjetore të trajnimit. Pas përfundimit të fazës së parë 2016-2018 është bërë vlerësimi i zbatimit të strategjisë dhe është hartuar plani i veprimit për vitet 2019-2020. Në planin e ri të veprimit janë përcaktuar objektivet: (i) Rritja e kapacitetit për politikën publike; (ii) Përmirësimi i kapaciteteve për integrim evropian; (iii) Modernizimi i administratës publike dhe transparenca në shërbim të publikut; (iv) Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe (v) Mbështetja e qeverisjes lokale.

Dokumentet strategjike me ndikim direkt në fushën e trajnimit:

- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017-2021 (SPPKP)
- Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 (SRrM)
- Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian, Një qasje pjesëmarrëse, Kosova 2020
- Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 (SMAP)
- Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020 (SRMFP)
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023,

2. ZHVILLIMI PROFESIONAL NË SHËRBIMIN CIVIL

Shërbimi civil i Kosovës, aktualisht numëron afër 19 000¹ të punësuar, të shpërndarë në institucionet e nivelit qendror, lokal dhe në institucionet e administratës së Sistemit të drejtësisë. Ligji për zyrtarët publikë përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të Shërbimit Civil, të cilat përfshijnë: kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjellja personale, avancimi në karrierë, zhvillimi profesional, koordinimi, mbikëqyrja, ngritja e kapaciteteve në shërbimin civil të Kosovës etj.

2.1. Programi i ofruar i trajnimit

Programi i trajnimit në mbështetje të zhvillimit të shërbimit civil ishte strukturuar në pesë objektiva strategjik dhe indikatorët e planifikuar: (i) Rritja e kapacitetit për politikat publike, (ii) Përmirësimi i kapaciteteve për integrim evropian, (iii) Modernizmi i administratës publike dhe transparenca në shërbim të publikut, (iv) Përmirësimi i menaxhimit të financave publike, (v) Mbështetje qeverisjes lokale.

Monitorimi i trajnimeve të zhvilluara është bërë përmes dymbëdhjetë (12) indikatorë standardë të trajnimit të platformës së trajnimit (SEIKAP): **Numri i kurseve, grupeve, ditëve, pjesëmarrësve, pjesëmarrjeve, certifikatave të ndara, mesatarja e grupit, nota mesatare, pjesëmarrja e minoriteteve për gjuhën serbe si gjuhë e dytë zyrtare, struktura gjinore, përfaqësimi institucioneve në trajnime dhe Struktura e pjesëmarrësve në trajnime.**

Krahas të dhënave statistikore të nxjerra nga platforma SEIKAP Indikatorët e trajnimit shoqërohen me komente dhe me një përmasë minimale të analizës për mënyrën si është planifikuar dhe si ka rezultuar zbatimi. Në këtë vit për shkak të trajnimeve online janë shtuar edhe indikatorët për **kurset online, fizike dhe mënyrën e mënyrën si janë buxhetuar.**

- Në zbatim të objektivit strategjik 1, "Rritja e kapacitetit për politikat publike", janë realizuar 35 kurse në fushat: Rritja e kapacitetit për hartimin dhe koordinimin e politikave publike, Rritja e kapacitetit për hartimin e legjislacionit cilësor, Zhvillimi i të drejtave dhe barazisë, Komunikimi me publikun. Në kurset e organizuar kanë marrë pjesë 875 pjesëmarrës.
- Në zbatim të objektivit strategjik 2, "Përmirësimi i kapaciteteve për integrim evropian", janë realizuar 10 kurse në fushat: Përgatitja e Acquis – harmonizimi i legjislacionit, Politikat Sektoriale të BE-së, Partneriteti Evropian dhe Negociatat me BE-në, Përgatitja e aplikimeve për fondet e BE dhe monitorimi i tyre.. Në kurset e organizuar kanë marrë pjesë 223 pjesëmarrës.
- Në zbatim të objektivit strategjik 3, "Modernizmi i administratës publike dhe transparenca në shërbim të publikut", janë realizuar 35 kurse në fushat: Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimit civil, Ofrimi i shërbimeve dhe zbatimi i procedurave administrative, Zhvillimi teknologjisë së informacionit, Llogaridhënia dhe transparenca ndaj publikut, Mbështetje kërkesave të trajnimit të institucioneve të veçanta. Në kurset e organizuar kanë marrë pjesë 1415 pjesëmarrës.

¹ Raport për gjendjen e shërbimit civil për vitin 2019, MPB

- Ne zbatim të objektivit strategjik 4, "Përmirësimi i menaxhimit të financave publike", janë realizuar 33 kurse në fushat: Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit, Rritja e kapaciteteve për menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm të financave publike, Rritja e kapaciteteve në çështjet e auditimit të brendshëm, Rritja e kapaciteteve në çështjet e prokurimit publik dhe partneriteti publiko-privat. Në kurset e organizuar kanë marr pjesë 1446 pjesëmarrës
- Ne zbatim të objektivit strategjik 5, "Mbështetje qeverisjes lokale", janë realizuar 14 kurse në fushat: Mbështetje qeverisjes lokale, Rritja e kapacitetit për hartimin e politikave lokale, Zhvillimi i qëndrueshëm, Mbështetje përmirësimit të cilësisë së shërbimeve komunale. Në kurset e organizuar kanë marr pjesë 488 pjesëmarrës

2.2. Rezultatet dhe indikatorët e trajnimeve

Nga të dhënat e përpunuara për katër indikatorët e parë të vendosur në tabelën 2, dhe tabelën 3, rezulton se në vitin 2021, IKAP-i ka trajnuar 4 447 nëpunës civil dhe të tjerë nga 7 000 mijë sa ishin planifikuar, ka organizuar 108 kurse trajnimi nga 80 sa ishin planifikuar, ka mbajtur 802 ditë nga 700 sa ishte planifikuar dhe rezulton se janë realizuar 10 616 pjesëmarrje nga 14 000 mijë sa ishin planifikuar. Të dhënat për të gjithë trajnimet e realizuara gjatë vitit 2021 të përpunuar për të gjithë indikatorët prezantohen në shtojcën 1 të këtij raporti.

Tabela 2. Planifikimi dhe realizmi i indikatorëve themelorë të planit të trajnimit për 2021

Komponentët e planit të trajnimit	Kurset	Ditët	Pjesëmarrës	Pjesëmarrja
Planifikimi	80	700	7000	14000
Realizmi	108	802	4447	10616
Realizmi në %	135%	114.57%	63.53%	75.83%

Shifrat e krahasuara tregojnë se indikatorët, kurse trajnimi dhe ditë trajnimi janë mbi realizuar dhe si ky rezultat ka ardhur nga kërkesat që kanë parashtruar institucionet dhe është bërë e mundur të mbahen më shumë ditë trajnimi pasi janë kursyer mjete nga mbajtja e trajnimeve të konvertuara nga mënyra fizike në mënyrën elektronike përmes kompjuterëve. Çdo ditë janë mbajtur 3.40 trajnime ($802/230=3.40$) ndërsa në kushte të mbajtjes së trajnimeve në formë fizike me buxhetin që kishim do mund të realizoheshin vetëm 424 ditë trajnimi. Tejkalmi i indikatorëve kurse dhe ditë trajnimi është ndikuar përkrahja nga donatorëve më të cilët janë realizuar 50 ditë trajnim. Ndërsa në mosrealizimin e indikatorëve pjesëmarrës dhe pjesëmarrje në trajnim kanë ndikuar disa faktorë ndër të cilët Pandemia Covid-19, puna me staf të reduktuar, ndryshimet organizative në institucione, ndryshimet ligjore dhe kapaciteti i organizmit të IKAP, etj.


Tabela 3. Indikatorët e trajnimit të realizuar gjatë vitit 2021

Nr	Objektivat strategjik	Kurset	Ditët	Pjesëmarrës	Pjesëmarrja
1	Rritja e kapacitetit për politikat publike	35	168	875	1803
2	Përmirësimi i kapaciteteve për integrim evropian	10	65	223	487
3	Modernizmi i administratës publike dhe transparenca në shërbim të publikut	33	307	1415	3733

4	Përmirësimi i menaxhimit të financave publike	14	187	1446	3643
5	Mbështetje qeverisjes lokale	16	75	488	950
Σ	Gjithsej	108	802	4447	10616


Indikatori “**Vlerësimi i trajnimeve**” është paraqitur në grafikun 1. Trajnimet e IKAP në këtë vit kanë marrë notën e vlerësimit 4.85. Vlerësimi i arritur është mbi normën 4 të vendosur për t’u arritur në këtë vit. Më së larti janë vlerësuar trajnimet në objektivin: Mbështetje qeverisjes lokale dhe në objektivin: Përmirësimi i kapaciteteve për integrim evropian. Vlera e këtij indikatori është ndër më të rëndësishmet në kuadër të gjithë indikatorëve, ai matet përmes formave të vlerësimit që plotësohen nga pjesëmarrësit në trajnim, nga trajnerë dhe nga menaxherët e trajnimit. Format të cilat aplikohen nga IKAP janë të përshkallëzuar me mundësi notimi nga 1 deri në 5 dhe me mundësi të komenteve. Kriteret e vlerësimit përfshijnë: përshtatshmërinë dhe përmbajtjen e modulit të trajnimit, kapacitetet e trajnerit, kushtet logjistike etj.

Grafiku 1. Vlerësimi i trajnimeve nga pjesëmarrësit në trajnim



Indikatori për “Strukturën gjinore” është paraqitur në grafikun me numër 2. Pjesëmarrës të gjinisë femërore ishin 2149 apo 48.32%, ndërsa 2298 pjesëmarrës apo 51.68 % ishin nga gjinia mashkullore. Ky tregues përpunohet duke krahasuar shifrat e realizuara dhe duke pjesëtuar me numrin total të pjesëmarrësve brenda vitit. Të dhënat e këtij treguesi mund të përdoren për të konstatuar respektimin e barazisë gjinore nga institucionet e vendit. Në zbatim të ligjit për gjuhët zyrtare janë ofruar trajnime në gjuhën serbe si gjuhë e dytë zyrtare përmes përkthimit. Në trajnimet e organizuara kanë marrë pjesë 103 pjesëtar të komunitetit serb. Në shërbimin civil numri i të punësuarve të këtij komuniteti është 1,399 apo 9.56%².

Grafiku 2. Pjesëmarrja në trajnime sipas gjinisë



² Raport për gjendjen e shërbimit civil për vitin 2020, MPB

Në tabelën 4, janë paraqitur statistikën e të punësuarve në shërbimin civil, të ndarë në nivelin qendror, lokal sipas kategorive funksionale dhe sipas gjinisë. Ndërsa në grafikun 3, është paraqitur pjesëmarrja në trajnime sipas **“Kategorive funksionale”** të shërbimit civil. Në këtë vit nga niveli drejtues i lartë kanë marrë pjesë 19 pjesëmarrës apo 0.43%, nga niveli drejtues 1037 pjesëmarrës apo 23.32%, nga niveli profesional 3 217 pjesëmarrës apo 72.34% dhe nga niveli administrativ 174 pjesëmarrës apo 3.91%.

Struktura e pjesëmarrësve në trajnimet e IKAP tregon se prezenca në trajnime është me e lart nga niveli drejtues dhe profesional dhe është me e ulët nga niveli drejtues i lart dhe niveli tekniko – administrativ.


Tabela 4. Karakteristikat edhe statistikën e shërbimit civil

Totali i NC	Institucioni		Kategoria funksionale e NC				Gjinia e NC	
	Niveli qendror	Niveli lokal	Nivel i lartë drejtues	Niveli drejtues	Niveli profesional	Nivel teknik	Mashkull	Femër
18,903	12,433	6,470	123	3,132	10,656	4,992	11,291	7,612
100%	66%	34%	0.7%	16.6%	56.4%	26.4%	59.7%	40.3%

Burimi: Raport për gjendjen e shërbimit civil për vitin 2019, MPB

Treguesi i “Kategorive funksionale” është njëri ndër treguesit kryesorë përmes të cilit matet aspekti strategjik i trajnimit. Synimet e IKAP janë rritja e pjesëmarrjes së kategorisë drejtues i lartë dhe drejtues në shifra me ndikim substancial.

Grafiku 3. Struktura e pjesëmarrësve në trajnime sipas kategorive funksionale të shërbimit civil




2.3. Përfaqësimi në trajnim

Programet e hartuara të trajnimit ishin me bazë të gjerë për mundësinë e përfshirjes, të disenjuara afërsisht për të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nga niveli qendror dhe lokal i administratës

publike, por me një fokus më të lartë, në synim ishin kategoritë drejtuese dhe ato profesionale, të cilat përbejnë kushtet thelbësore për një administratë, e cila arrin të iu përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe të zbatojë politikat qeveritare.

Treguesi për përfaqësimin e institucioneve në trajnime është strukturuar në 7 grupime: **Zyrat e presidentit, Kuvendit, kryeministrit dhe ministrit (grup i përbashkët), Agjencitë ekzekutive, Agjencitë e pavarura, Komunitet, Kompanitë publike, Sistemi i drejtësisë dhe Njësitë rajonale.** Të dhënat e prezantuara në grafikun 4.

Grafiku 4. Përfaqësimi i institucioneve në trajnime



Nga të dhënat, për përfaqësimin e institucioneve të lartcekura në trajnimet për të cilat IKAP ka mandat, rezulton se në këtë vit në trajnimet e IKAP pjesëmarrja më e lartë në shkallë grupi ka qenë nga qeverisja lokale dhe ministritë, ndërsa pjesëmarrja e më e vogël ka qenë nga kompanitë publike të cilat kanë të drejtë të marrin pjesë në trajnimet e IKAP, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Këto të dhëna tregojnë se “klientela“ e IKAP-it edhe në aspektin e strukturave është goxha e gjerë, e cila rezulton nga kapaciteti ligjor që e ka IKAP sipas Ligjit të për IKAP dhe sipas Ligjit të prokurimit publik.


3. MËNYRA E OFRIMIT TË TRAJNIMIT DHE DIGJITALIZIMI I TRAJNIMIT

Pandemia COVID 19 ka pasur ndikim të konsiderueshëm në mënyrën e ofrimit të trajnimeve në vitin 2021, ndërsa rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe nevoja e rritjes së efikasitetit të shërbimit dhe përshtatjes sa më të mirë të kërkesave që kanë nëpunësit civilë ka ndikuar që IKAP-i të fillojë projektin për zbatimin e trajnimeve digjitale.

3.1. Trajnimet tradicionale dhe trajnimet virtuale

Në strategjinë e IKAP-it për vitin 2021, nga 700 ditë sa ishin planifikuar, ishte paraparë që 140 ditë, përkatësisht 20% e të gjitha trajnimeve të mbahen në mënyrën online dhe 560 ditë, përkatësisht 80% në mënyrë fizike. Siç e cekëm edhe në fillim të raportit, edhe gjatë këtij viti për shkak të pandemisë COVID 19 ka ndryshuar mënyra e mbajtjes së disa trajnimeve. Dhe se raporti gati sa është përmbysur. Nga të dhënat e përpunuara, siç shihet, edhe në grafikun 5. rezulton se nga gjithsej 802 ditë të realizuara të trajnimit, 464 ditë trajnimi janë mbajtur në mënyrën online ose 58%, ndërsa 338 janë mbajtur në mënyrë fizike ose 42%.

Grafiku 5. Mënyra e realizimit të ditëve të trajnimit



Mbajtja e trajnimeve në mënyrën online nuk është mjeti më i përshtatshëm për kushtet e punës dhe të pajisjeve që kanë nëpunësit civilë, por ndikimi në buxhetin e trajnimit ka rezultuar të jetë shumë i lartë, pasi që janë kursyer shumë mjete dhe janë mbajtur më shumë ditë trajnimi.

3.2. Digjitalizimi i trajnimit


Investim në digjitalizimin e trajnimit kanë filluar në fund të vitit 2019. Në vitin 2020 është instaluar Platforma ILIAS në serverët e ASHI-së. Për shkak të pandemisë, në vitin 2020 ka ngadalësim në aktivitetet për finalizimin e projektit. Në vitin 2021 kanë filluar vazhduar aktivitete përsëri me një ritëm të ngadalshëm pasi ekspertët kanë punuar në distancë:

- Është përgatitur draft manuali për përdorimin e platformës;
- Janë testuar instrumentet e platformës si regjistrimi i përdoruesve si dhe testimi i veglave që përmban ky sistem;
- Janë mbajtura disa trajnime pilot.

Për realizimin e trajnimeve digjitale është zgjedhur platforma ILIAS, e cila paraqet Sistemin e Integruar të Mësimi. ILIAS-i është shtëpi (ndërtesë) virtuale me klasa virtuale, përkatësisht platformë E- mësimi (ose Sistem i Menaxhimit të Mësimi, shkurtimisht SMM) që mundëson kombinimin e mësimi në punë dhe të mësuarit në shtëpi apo kudo që gjendemi. ILIAS është një nga Sistemet e para të Menaxhimit të Mësimi që është përdorur në universitete. Është lansuar

nga Fakulteti i Menaxhimit, Ekonomisë dhe Shkencave Sociale të Universitetit të Kölnit në Gjermani.

Projekti për trajnime digjitale është duke u zhvilluar me mbështetjen nga Ministria Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Energjetike (BMWi), përmes Projektit “Mbështetje për digjitalizimin e trajnimit BE-në, në administratën publike të Ballkanit Perëndimor 2021-22” dhe Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) të Kosovës.



Në vitin 2022 nga IKAP-i janë planifikuar të mbahen 5 (pesë) kurse trajnimi përmes sistemit ILIAS.

4. BASHKËPUNIMI NË SFERËN E TRAJNIMIT

Gjatë këtij viti, IKAP-i ka zhvilluar aktivitete të bashkëpunimit me disa organizata partnere, donatorë dhe institucione të vendit. Bashkëpunimi me organizatat partnere dhe donatorë është zhvilluar në funksion të mbështetjes së shërbimit civil dhe kapaciteteve të IKAP, ndërsa bashkëpunimi me institucione vendore është zhvilluar në funksion të mbështetjes së nevojave për trajnime që kanë parashtruar institucionet pranë IKAP. Për tre raste janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

4.1. Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë

Organizatat me të cilat është bashkëpunuar gjatë këtij viti ishin: Projekti “Mbështetje për Kontratën e Reformës Sektoriale mbi Reformën e Administratës Publike (RAP)”, GIZ, NOVUS, EIPA, PECK III, Terres des Hommes, DEMOS, Aleanca Franceze dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë, UN WOMEN etj.

1. Projekti “Mbështetje për Kontratën e Reformës Sektoriale mbi Reformën e Administratës Publike (RAP)”

Në këtë vit ka filluar aktivitetin projekti i ri “Projekti Mbështetje për Kontratën e Reformës Sektoriale mbi Reformën e Administratës Publike (RAP)”, i cili ofron mbështetje në zbatimin e RAP dhe përfitues janë disa institucione. Në komponentin e trajnimit, në të cilin IKAP është përfitues, është kryer vlerësimi i nevojave për trajnim dhe është hartuar plani afatmesëm i trajnimit të nëpunësve civilë gjatë viteve 2022-2024. Në kuadër të këtij projekti IKAP ka statusin e anëtarit të komitetit drejtues më të drejtë vote. Projekti “Mbështetje për Kontratën e Reformës Sektoriale mbi Reformën e Administratës Publike (RAP)” financohet nga Komisioni Evropian. Projekti vazhdon aktivitetet deri në vitin 2023.

2. Digjitalizimi i trajnimeve të BE-së në Administratën Publike të Ballkanit Perëndimor

Në këtë vit kanë filluar aktivitetet e projektit “Mbështetja për digjitalizimin e trajnimeve lidhur me BE-në për Administratën Publike në Ballkanin Perëndimor 2021-22”. Projekti do të mbështesë IKAP-i në ngritjen e kapaciteteve për aplikimin e digjitalizimit në ofrimin e trajnimeve. Në fazën e parë të projektit është punuar platforma elektronike ILIAS dhe janë mbajtur disa trajnime bazike. Në proces është punimi i manualit dhe të modelit standard për ofrimin e trajnimeve digjitale. Projekti zgjat deri në fund të vitit 2022 dhe financohet nga Ministria Federale e Gjermanisë për Ekonomi dhe Energji (BMWi).


3. Bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare Gjermane (GIZ)

Gjatë vitit 2021 Organizata Gjermane GIZ, është involvuar në sferën e trajnimit përmes dy projekteve. Hartimi i kurrikulës së trajnimit për teknologjinë e informacionit, ishte projekti i parë ndërsa projekti i dytë ishte i ndërlidhur me hulumtimin e nevojave për trajnim për barrën administrative. Në projektin e parë në këtë bashkëpunim ishte e kyçur Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, ndërsa projekti i dytë është zbatuar nga bashkëpunimi i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Për të dy projektet do të mbahen trajnime në vitin 2022.

4. Bashkëpunimi në ofrimin e trajnimeve për shërbimin civil

Për realizimin e aktiviteteve, në ofrimin e trajnimeve për nëpunësit civilë, IKAP ka bashkëpunuar me disa organizata. Me projektin 3. PECK III, ka bashkëpunuar në organizmin e trajnimit për trajnerë, Mbrojtjen e sinjalizuesve, me organizatën Terres des Hommes, ka bashkëpunuar në organizmin e trajnimeve në fushën mbrojtjes për fëmijët në konflikt me ligjin, me projektin Mbështetja për Promovimin dhe Zbatimin e Agjendës së Modernizimit të Administratës Publike (MPZAMAP) NOVUS, ka realizuar trajnimin Llogaridhënia menaxheriale, me Aleanca Franceze dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë, janë organizuar kurset e gjuhës frënge. Në bashkëpunim me "Institutin Evropian i Administratës Publike" (EIPA) është organizuar kursi i trajnimit pronësia intelektuale. Më te gjithë këta partner janë trajnuar 488 pjesëmarrës ne 50 dit trajnimi përmes 8 kurseve të trajnimit. Indikatorët për ditë dhe pjesëmarrës trajnimi janë paraqitur në grafikun 6.

Grafiku 6. Trajnimet me bashkëpunim me partnerë dhe donatorë



5. Marrëveshjet për bashkëpunim

Për zbatimin e programit të trajnimit për etikën dhe integritetin në administratën publike IKAP, ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me Qendra për integritet në sektorin e mbrojtjes(CIDS) / OLSO/NORVEGJI. CIDS i ka ofruar IKAP-it trajnimin për trajnerë për 5 trajnerë të përzgjedhur nga IKAP. Si përfitues i projekti ishte edhe Shkolla Shqiptare për Administratë Publike e Shqipërisë (ASPA). Marrëveshja për bashkëpunim është nënshkruar më 09.09.2021.

Një marrëveshje për bashkëpunim është nënshkruar edhe me organizatën UN WOMEN. Përmes marrëveshjes, dy palët janë pajtuar të bashkëpunojnë në ofrimin e trajnimeve për nëpunësit civil në zbatimin e politikës së qeverisë së Kosovës kundër dhunës seksuale. Marrëveshja është nënshkruar në 01.12.2021.

Nr.	Tabela 5. Organizatat më të cilat janë nënshkruar Marrëveshjet për bashkëpunim(MIM)	Data e nënshkrimit
1	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave(UNWOMEN)	01.12.2021
2	Qendra për integritet në sektorin e mbrojtjes(CIDS) / Olso/Norvegji	10.09.2021
3	Ministria Financave dhe transfereve	15.02.2021

4.2 Bashkëpunimi me institucione

IKAP bashkëpunon me të gjitha institucionet e shërbimit civil për, përmes njësive të personelit, megjithatë me institucionet që kanë përgjegjësi në zbatimin sistemeve që kanë aplikim të gjerë në administratë nga të cilët kërkohet të transmetohen edhe përmes trajnimit, IKAP ka një bashkëpunim të shtuar, i cili në disa raste është materializuar me marrëveshjet për bashkëpunim.

- Ne shkurt të vitit të kaluar është nënshkruar IKAP ka nënshkruar një Marrëveshje për Bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe transfereve. Objekti i marrëveshjes përcakton interesin dhe vullnetin për organizimin e trajnimeve që ndërlidhen në fushëveprimin e Ministrisë së Financave dhe për përkrahjen e kërkesave të saj për trajnim që ka ministria në fjalë. IKAP vazhdimisht bashkëpunon, por dhe organizon trajnime me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Brendshëm, Departamentin Qendror për Partneritet Publiko-Privat, Departamentin e Buxhetit dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore etj.
- Ne bashkëpunimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil kanë vazhduar trajnimet për nëpunësit e regjistrimit civil dhe zyrtarët konsullorë. Bashkëpunimi i palëve është i rregulluar me marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2016.
- Ne bashkëpunim me Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP), e rifreskuar janë realizuar programet e trajnimit për Prokurimin Publik themelor dhe programi i avancuar. Bashkëpunimi i palëve është i rregulluar me marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2019.
- Ne vitin e kaluar IKAP ka përkrahur trajnimet për Matjen e performancës komunale dhe verifikimi i të dhënave për fushat e arsimit parauniversitar të paraqitura nga Ministria e Pushtetit lokal.


5. TRAJNIMET PËR TRAJNER DHE REFORMA E TRAJNERËVE

Cilësia e trajnimit varet nga cilësia e trajnerëve. Angazhimi i trajnerëve pavarësisht kategorive të tyre bëhet konform bazës ligjore dhe tarifave për pagesat e precizuara. Në këtë vit janë organizuar dy trajnime për trajnerë dhe ka filluar reforma e trajnerëve.

5.1. Angazhimi i trajnerëve në trajnime

Gjatë vitit 2021 IKAP për ofrimin e shërbimit të trajnimit ka angazhuar 142 trajnerë. Prej tyre 118 apo 83.10% ishin **“Trajner i IKAP(TI)”**, që i bie se këta trajnerë kanë kryer trajnimin për shkathtësi të trajnimit në IKAP dhe kanë marrë certifikatat përkatëse, 21 apo 14.79% ishin **“Trajner i brendshëm”(TB)** që i bie se këta trajnerë kanë kualifikimet adekuate për temën e zhvilluar dhe janë nëpunës të shërbimit civil, 3 apo 2.11% ishin trajnerë të angazhuar ishin nga organizatat tjera vendore apo tregu vendor dhe në bazën ligjore të IKAP janë të emërtuar si **“Trajner i jashtëm”(TJ)** dhe në grupin e fundit për nga kapaciteti i angazhimit ishin **“Trajnerët ndërkombëtarë”(TN)** në vitin 2021 nuk kishte ndonjë trajner të angazhuar.

Grafiku 7. Angazhimi i trajnerëve gjatë periudhës 2021



Nga të dhënat e prezantuar, në grafikun 7, shihet se IKAP gjatë këtij viti ka shfrytëzuar shërbimet me një përqindje më të lartë të trajnerëve të IKAP. Në vlera më të ulëta po, jo të largëta në mes veti qëndrojnë të dhënat për kategoritë trajner i brendshëm dhe trajner i jashtëm. Nga të dhënat, për kualifikimet e trajnerëve, shohim se pjesa më e madhe e trajnerëve kanë kualifikimet master, i diplomuar dhe tre prej tyre kanë titujt e doktorit të shkencave. Kriteri i angazhimit të trajnerëve është që ata të jenë specialistë të fushave, të kenë eksperiencë profesionale dhe të jenë të certifikuar në shkathtësitë e trajnimeve për trajnerë.

5.2. Trajnimet për trajnerë

Në vitin 2021 IKAP ka organizuar dy trajnime për trajnerë.

- Trajnimi “Sinjalizuesit dhe e drejta e tyre”. Për të marrë pjesë në trajnim kanë aplikuar 48 kandidatë, por nga komisioni përzgjedhës për të vijuar trajnimin janë përzgjedhur 16 kandidatë të cilët kanë i plotësuar kriteret për pranim. Tri fazat tjera të trajnimit, mbajtja e trajnimit, vlerësimi përmes testit dhe vlerësimi përmes prezantimit nuk janë mbajtur për shkak se trajnerët e kontaktuar ishin jashtë Kosovës dhe në synim ishte mbajtja e trajnimit në formë fizike. Trajnimi është mbështetur dhe zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, zyrën e tij në Kosovë. Trajnimi pritet të përfundojë në vitin 2022.

- Në fushën etikës dhe e integritetit në Administratë Publike janë trajnuar 5 trajnerë të përzgjedhur nga rrejtë i brendshëm i trajnerëve, të cilët janë certifikuar në trajnime paraprake, por që trajnimi është mbajtur në funksion të ofrimit të modulit të rinovuar të trajnimit. Trajnimi është organizuar me mbështetjen organizatës Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (Centre for Integrity in the Defence Sector CIDS) nga Oslo (Norvegji) dhe selinë e saj në Kosovë, me të cilën IKAP ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim. Në trajnimin për trajnerë krahas trajnerëve të përzgjedhur nga IKAP kanë marrë pjesë edhe trajnerët e përzgjedhur nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

IKAP në strategjinë e tij synon rinovimin e vazhdueshëm të rrjetit të trajnerëve. Që nga viti 2003, kur është themeluar IKAP, ka organizuar 54 trajnime për trajnerë në të cilat trajnime titullin trajner i IKAP e kanë fituar 799 kandidatë. Në tabelën 5, janë paraqitur fushat në të cilat janë certifikuar trajnerët nga IKAP. Nevoja e rinovimit në vitet e fundit është bërë akoma më e madhe për shkak të ndryshimit të objektivave të trajnimit dhe ndryshimit të statusit të trajnerëve, ku një pjesë e madhe e tyre nuk kanë mundësi të angazhohen në trajnime. Kjo situatë ke bërë që të fillohet me reformën e trajnerëve dhe me afatizimin e certifikatave të trajnerëve.

Tabela 5. Numri i trajnerëve të certifikuar nga IKAP sipas fushave trajnuese 2003-2021

Nr.	Fushat e trajnimit	Numri i trajnerëve	
1	Menaxhim i përgjithshëm	67	8.39%
2	Administratë e përgjithshme	238	29.27%
3	Burime njerëzore	97	12.24%
4	Buxhet dhe financa	218	27.28%
6	Teknologji informative	12	1.5%
7	Çështje komunale	73	9.14%
8	Bashkimi Evropian	94	11.76%
	Gjithsej	799	100%

5.3. Reformimi i sistemit të trajnimeve për trajnerë

Për shkak të problemeve, lidhur me administrimin, objektivitetin, kualitetin dhe dobësi të tjera të konstatuara gjatë implementimit të Udhëzimit Administrativ UA 13/2018 për kushtet për angazhimin, kategorizimin dhe pagesën e trajnerëve, IKAP ka filluar reformën e trajnerëve. Udhëzimi aktual është ndryshuar dhe ndarë në dy pjesë, në pjesën që rregullon kushtet e përgjithshme, kategoritë, kontratat dhe pagesat. Ky dokument do të miratohet nga Qeveria e vendit dhe në pjesën që rregullon përzgjedhjen, angazhimin, ricertifikimin dhe performancën e trajnerëve. Ky dokument do të miratohet nga drejtori i përgjithshëm i IKAP. Reforma e trajnerëve do të ketë impakt të lartë në kualitetin e trajnimit pasi që do të eliminohen mangësitë e konstatuara dhe në aspektin financiar ndikimi i reformës është minimal. Reforma pritet të përmbyllet në vitin 2022.

6. FINANCIMI I IKAP NË VITIN 2021

Në këtë kapitull do të prezantohen informacionet për burimet e financimit dhe për mënyrën si është menaxhuar buxheti.

6.1. Burimet e financimit

Në vitin 2021 buxheti i tërësishëm i ndarë nga Qeveria e vendit për IKAP-in ishte 301,156.26 €. Buxheti i ndarë për IKAP në kategorinë mallra dhe shërbime ishte buxheti më i lartë i ndarë deri më tani nga qeveritë e vendit. Në grafikun 8, është prezantuar ndarja e buxhetit për IKAP që nga viti 2015.

Grafiku 8. Buxheti i ndarë për IKAP 2015-2022



6.2. Menaxhimi dhe shfrytëzimi mjeteve financiare të IKAP

Buxheti i ndarë është përdor për financimin e trajnimit dhe për shërbimet mbështetëse të cilat prezantohen në shtojcën 2 të këtij raporti

6.2.1. Pagesat për trajnerë

Për ekzekutimin e shërbimeve për pagesat e trajnerëve janë aplikuar “kontrata mbi vepër” vlera e këtij shërbimi për vitin 2021 arrinë shumën 65,470.00€.

Tabela 6. Ekzekutimi të buxhetit sipas kategorive ekonomike

Kategoritë	Alokimet	Shpenzimet	Mbetja	Shpenzimet %
Paga dhe meditje	146,033.23 €	114,783.57 €	31,249.66 €	78.60%
Mallra dhe shërbime	148,622.03 €	136,688.75 €	11,933.28 €	91.97%
Shpenzimet komunale	6,500.00 €	1,065.85 €	5,434.15 €	16.40%
Shpenzimet kapitale	0,00 €	0,00 €	0,00 €	0,00 €
Gjithsej	301,155.26 €	252,538.17 €	48,617.09 €	83.86%

6.2.2. Blerjet përmes procedurave të prokurimit publik

Gjatë vitit 2021 përmes procedurave të prokurimit janë blerë 20 kompjuterë për staf në vlerë prej 26,853.12 euro, materiali shpenzues për shërbimin e trajnimit dhe për aspektet administrative janë në vlerë prej 21,901.94 euro. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar nga Departamenti i Prokurimit të MAP dhe më pas në MPB për faktin se në IKAP mungon kjo pozitë pune.

Buxheti i IKAP, edhe pse më i vogël nga sa IKAP kishte parashtruar kërkesën për buxhet, nuk është realizuar në tërësi. Për shërbimin e trajnimit ishte planifikuar të shpenzohen 222,442.00 euro për trajnimin 7 000 nëpunësve civilë (7 000 x 2 ditë 14000 pjesëmarrje) ndërsa që rezultuan të trajnohen 4447 nëpunës me 10616 pjesëmarrje.

Faktorët që kanë ndikuar të mos shpenzohet buxheti janë si në vijim: në kategorinë mallra dhe shërbime, kalimi nga trajnimet fizike në trajnimet elektronike ka ndikuar që të kursehen **11,933.23**, mungesa e pjesëmarrjes në trajnime sipas standardit të IKAP kishte planifikuar të realizohen 14 000 pjesëmarrje, ndërsa janë realizuar 1016 pjesëmarrje ka ndikuar që të kursehen po ashtu janë kursyer nga shpenzimet e materialit shpenzues. Në kategorinë paga dhe mëditje mbetja ka ardhur pas IKAP ka pas një vend vakant gjatë gjithë vitit. Në kategori shpenzime komunale kursim është bërë për faktin se ndërtesa e re e IKAP ende menaxhohet nga departamenti i inxhinierimit dhe të gjitha shpenzimet komunale bëhen nga ky departament.

6.3. Financimi nga fondet donatore

Në kapitullin Bashkëpunimi janë prezantuar projektet e bashkëpunimit, ndërsa që në këtë pjesë prezantohen vlerat financiare që ofrohen nga partnerët dhe donatorët, por meqë fondet janë menaxhuar nga ana tyre ne nuk e kemi informacionin e vlerave financiare të:

1. Bashkimi Evropian. BE financon projektin "Mbështetje për kontratën e reformës sektoriale për reformën e administratës publike (RAP)". Në kuadër të projektit, IKAP është përfitues i komponentës në emërtimin "Mbështetje kapaciteteve të IKAP. Shuma totale e kontraktuar është 2,044,600.00 euro ndërsa që IKAP-it në kuadër të projektit i janë dedikuar 262 ditë të punës. Projekti implementohet nga konzorciumi i organizatave Euricena, Shërbimet Ndërkombëtare të GIZ dhe Instituti Evropian për Politika Publike (EIPP).

2. Ministria e Ekonomisë dhe Energjisë Gjermanisë (BMWI). Kjo ministri mbështet IKAP-in për digjitalizimin e trajnimit përmes Projektit në mbështetje të digjitalizimit të trajnimit. Fondi i projektit ka vlerën 1.50,000,00 euro për vitet 2021-2022. Buxheti i projekti menaxhohet nga ekipi i përzgjedhur nga pala e donatorëve.

3. Organizata Ndërkombëtare Frankofone (OIF). IKAP në bashkëpunim me OIF në vitin 2020 ka filluar zbatimin e kurseve të trajnimit për gjuhën frënge për nëpunësit civilë. Organizmi bëhet në bazë të marrëveshjeve mes Ministrisë së punëve të jashtme, ish-Ministrisë së Administratës Publike të Kosovës dhe Ambasadës së Francës, të nënshkruar në vitin 2019. Të dy palët participojnë në zbatimin e kurseve. OIF ndan vlerë prej 4,125.00€ ndërsa IKAP ndan vlerën prej 0,00.00. Buxhetimi bëhet në baza vjetore dhe marrëveshja zgjat deri në vitin 2023.

4. **Shërbimet Ndërkombëtare të GIZ-it** kanë mbështetur IKAP-in në hartimin e kurrikulave për teknologjinë informative për vitin 2022-2024. Përkrahja është dhënë në formë të ekspertit, ndërsa që aspekti financiar është menaxhuar nga ana e GIZ-it.

5. **Pesëdhjetë ditë trajnimi.** Në kapitullin 5 janë dhënë informacione për bashkëpunimin me partnerë, disa prej të cilëve kanë mbuluar shpenzime trajnimi kryesisht për trajnerë në 8 kurse trajnimi në një total prej 50 ditë trajnimi vlera e të cilave nuk kalon shumen prej 6 000€, llogaritur në vlerat e tarifave që aplikon IKAP. Pagesat janë bërë direkt pa kaluar në fondin e IKAP.

7. ZHVILLIMI ORGANIZATIV

Në këtë kapitull do të prezantohen aktivitetet lidhur me ristrukturimin institucional, procedurat e personelit, investimet në kushtet për punë dhe në infrastrukturë dhe në mënyrën si është duke funksionuar komunikimi dhe informimi i IKAP në aspektin e brendshëm dhe me palët tjera.

7.1. Ristrukturimi institucional i IKAP

Bazuar në synimet e IKAP dhe në kërkesat e bazës ligjore për standardet e organizmit, IKAP ka përgatitur Projekt Rregulloren e sistematizimit dhe organizmit të brendshëm, me dokumentet përcjellëse (memorandumin shpjegues, raportin e konsultimit dhe vlerësimin e ndikimit financiar), është përkthyer dhe i është dërguar ministrit për të proceduar për fazat e miratimit. Për shkak të zhvillimeve, lidhur me Planin legjislativ, dokumenti nuk është miratuar në afatin e paraparë (29 tetor 2021), por miratimi është shtyrë për muajin qershor të këtij viti 2022. Në strukturën e organizmit janë bërë ndryshimet siç kërkon ligji i administratës shtetërore, ndërkohë që nuk është rritur numri punonjësve. Funksionet mbështetëse janë shuar dhe janë krijuar pozita që i përgjigjen në tërësi funksionit të trajnimit. Sipas Projekt strukturës së re të organizimit, IKAP do të ketë 19 të punësuar, të ndarë në tri njësi.

7.2. Menaxhimi i personelit

IKAP gjatë vitit 2021 kishte 18 nëpunës, ndërkohë që në strukturën e saj ka 19 pozita pune të aprovuara. Për shkak të pushimeve të lehonisë dhe skadimit të kontratës së drejtorit të përgjithshëm në pjesën më të madhe të vitit IKAP ka punuar me 16 nëpunës.

- **Ndryshimet në pozita:** Bazuar në ligjin e ri për zyrtarët publikë, më datën 5 maj 2021 Drejtorit të përgjithshëm i ka skaduar kontrata e punës dhe me vendim të ministrit është bërë zëvendësimi, duke u vendosur në këtë pozitë drejtori i departamentit të trajnimit, me procedurë të njëjtë është bërë zëvendësimi i pozitës së drejtorit të trajnimit.
- **Trajnimi i stafit të IKAP:** 13 nëpunës nga 18 gjithsej janë përfshirë në aktivitete trajnimi, punëtori, konferenca të cilat janë mbajtur nga IKAP dhe organizatat tjera në formë fizike dhe elektronike. Aktivitetet e aftësimit kanë përfshirë: çështjet e administratës publike, të lidërshit, politikat publike, menaxhimit të kualitetit, rregulloret e shërbimit civil, prokurimi publik, çështje të etikës dhe integritetit. Në të gjitha aktivitetet e aftësimit rezulton se gjatë vitit të kaluar stafi i IKAP ka vijuar mesatarisht 7 ditë ($106/15=7.06$ ditë) trajnim për 15 nëpunës.
- **E drejta për pushime:** Gjatë vitit 11 nëpunës kanë marrë pushime mjekësore, duke shfrytëzuar një total prej 137 ditëve. Dy nëpunës kanë qenë në pushim të lehonisë, ndërsa pushimet vjetore nuk janë shfrytëzuar në tërësi.
- **Angazhimi në detyra shtesë:** Stafi në tërësi gjatë vitit ka pasur angazhim në punë shtesë, në veçanti në pjesëmarrje në komisione vlerësimi për trajnimet për trajnerë, pjesëmarrje grupe pune për hartim të dokumenteve dhe angazhime sipas legjislacionit.


7.3. Investimet në kushtet për punë dhe në infrastrukturë

- Me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për punë, stafi i IKAP është pajisur me kompjuterë, tavolina, llaptopë, fotokopje.
- Krahas këtij investimi, janë ndërmarr masa të korrigjimit të disa defekteve të ndërtesës së IKAP, e cila është vënë në funksion me 13 mars të vitit 2020. Me konkretisht janë korrigjuar mangësitë në pajisjeve klimatike, mureve, dritareve, amortizuesve të zhurmës në hapësirat e qëndrimit ditor si dhe janë eliminuar defektet e qatis. Korrigjimet janë bërë në mbikëqyrjen e departamentit të inxhinierimit në MPB.

7.4. Komunikimi dhe informimi

Për IKAP, roli i komunikimit dhe informimit është jetik për zbatimin misionit dhe reformave të ndërmarra pasi ky segment mundëson shkëmbimin e informacionit dhe rritjen e vlerës së shërbimit të ofruar.

- Për komunikimin me palët e jashtme në veçanti për shpërndajnë e informacionit për trajnimin janë përdorur kanalet e komunikimit me njësitë e personelit, në mënyrë masive është përdor platforma sociale Facebook përmes së cilës janë bërë 250 publikime të aktiviteteve dhe njoftimeve të ndryshme. Disa nga postimet e aktiviteteve janë bërë në dy gjuhët zyrtare, shqipe. Është përdor edhe Webfaqja por në masë të kufizuar pasi e njëjta është dëmtuar ndër vite dhe është vendosur si prioritet për tu ndërtuar webfaqja e re meqë nga analiza e bërë ka rezultuar se e njëjta nuk mund të riaftësohet.
- Qarkullimit dhe koordinimit të informacionit, brenda organizatës, i është kushtuar kujdes. Janë vendosur shenjat numerike të klasifikimit të dokumenteve zyrtare sipas strukturës organizative, janë avancuar shabllonet dhe janë precizuar afatet për procesin e planifikimit dhe raportimit. Këto masa janë ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të llogaridhënies dhe transparencës brenda organizatës.



8. PRIORITETET PËR VITIN 2022

Reformat e ristrukturimit institucional, reforma e trajnerëve, ndërtimi kapaciteteve për digjitalizimin e trajnimit të filluar në vitin 2021 pritet të përmbyllet në vitin 2022. Ndikimi i këtyre reformave në të ardhmen e IKAP është i lartë, ndërsa që reforma të reja avancimi si i statusit, reformimi i platformave elektronike, reformimi i rrjetit të trajnerëve do të startojnë në vitin 2022. Suksesi i reformave sfidohet nga zhvillimet ligjore në shërbimin, të cilat janë në proces, në veçanti suksesi i IKAP do të varet nga modeli i zgjedhur i trajnimit i cili do të vendoset në ligjin e zyrtarëve publik, i cili është në plotësim ndryshim.

1. Përmirësimi i statusit të IKAP

IKAP ka statusin e agjencisë ekzekutive, posedon pavarësi administrative, financiare dhe ka nevojë të përmirësojë pavarësinë akademike duke marrë përgjegjësinë e plotë në vlerësimin e nevojave të hartimit të programeve të trajnimit pasi kjo komponentë ndër vite ka rezultuar me një funksionalitet të pamjaftueshëm, e ndikuar nga mangësitë e bazës ligjore dhe kapaciteteve të stafit. Shansi i realizimit të progresit në këtë fushë është e lidhur me ndryshimin dhe plotësimin që do të bëhet në kuadër të ligjit për IKAP.

2. Ristrukturimi institucional

IKAP ka hartuar rregulloren e organizmit të brendshëm, në proces është miratimi i saj ndërsa pas miratimit do të shfaqet sfida e funksionalizimit. Vështirësitë qëndrojnë në faktin se në 11 pozita pune janë pozita të reja, 6 pozita do të rikonstruktohen, ndërsa vetëm dy pozita do të ruajnë përshkrimet aktuale. Struktura e re do të bëjë të nevojshëm hartimin e një plani afatgjatë për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme përfshirë ristrukturimin e procedurave operacionale të brendshme.

3. Reforma e rrjetit të trajnerëve

Në zbatim të reformës së trajnerëve është ndryshuar dhe plotësuar Udhëzimi Administrativ UA. 13/2018 për kushtet për angazhimin, kategorizimin dhe pagesën e trajnerëve. Në zbatim të këtij udhëzimi do të hartohet edhe udhëzim për përzgjedhjen, angazhimin, ricertifikimin dhe vlerësimin e performancës së trajnerëve në institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe si hap i tretë është reformimi i rrjetit të trajnerëve, IKAP do të riorganizojë ricertifikimin e trajnerëve me qëllim të përmirësimit të metodologjisë së trajnimit.

4. Avancimi i sistemeve elektronike

Në planin e punës për vitin 2022 do të punohet webfaqja e re pasi Webi aktuale është dëmtuar dhe ka funksionalitet minimal. Në përshtatje të bazës ligjore të ligjit për zyrtarët publikë do të ndryshohet dhe avancohet platforma e menaxhimit të trajnimit SEIKAP.

5. Rritja e vëllimit, cilësisë së trajnimit dhe buxhetit të IKAP

IKAP duhet të rrisë vëllimin e trajnimit bazuar në nevojat për trajnim. Aktualisht IKAP-i trajnon jo më shumë se 24% të krejt efektivit të shërbimit civil, i cili ka afër 19,000 nëpunës civil. Prej vlerës 100%, 5-10% të çdo viti janë si rezultat i përkrahjes së donatorëve. Bazuar në praktikën e institucioneve të zhvilluara dhe vlerësimet e SIGMA-s për të pasur trajnim, i cili ndikon në zhvillimin e shërbimit civil, vëllimi i trajnimit duhet të rritet në shifrën mbi 30, me synim të

arrijë shifrën deri në masën 50% për vit apo edhe duke e kaluar. Për t'i arritur këto vlera buxheti i IKAP duhet rritur.

6. Rregullimi i sistemit të trajnimit në shërbimin civil

Sistemi i trajnimit në shërbimin civil ka nevojë të avancohet duke vendosur detyrime më të qarta për planifikimin, zbatimin, matjen e rezultateve dhe për financimin e trajnimit për të gjithë aktorët e kornizës institucionale të menaxhimit të trajnimit DMZP, IKAP dhe institucionet.

Ndër praktikat e mira që mundësojnë funksionalitetin e sistemit të trajnimit janë vendosja e një modeli të standardizuar për menaxhimin e trajnimit, për të gjitha institucionet, qartësimi i mënyrës së zbatimit të trajnimeve të përgjithshme dhe trajnimeve specifike dhe i financimit të tyre, Financimi i trajnimit dhe buxheti duhet të bëhet sipas modelit të emërtuar "Buxheti në paga". Modeli i buxheti bazuar në paga siguron buxhet për trajnimin e çdo nëpunësi civil dhe i mundëson IKAP-it të ketë një buxhet stabil, në të njëjtën kohë modeli rrit përgjegjshmërinë e të gjitha palëve për të siguruar një trajnim sa më cilësor. Po ashtu një praktikë e mirë që aplikohet në vende me sistem të trajnimit të konsoliduar është vendosja e një numri të ditëve të trajnimit për nëpunësit civilë duke e zbritur numrin e trajnimeve të detyrueshme si një mundësi e që planifikimi i trajnimit të jetë më elastik.

Rregullimi i sistemit të trajnimit është i mundur të bëhet në kuadër të Ligjit për zyrtarë publik i cili është në plotësim ndryshim dhe sigurisht të hartimit të rregullores së trajnimit, e cila do të specifikojë rregullat konkrete.

9. PËRFUNDIMI

Duke analizuar gjithë veprimtarinë e IKAP, parë në tregues sasiorë dhe cilësorë gjatë vitit 2021, mund të arrijmë në përfundimin se dy prioritetet kryesore: mbështetja e zhvillimit të shërbimit civil dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme nuk janë përmbushur plotësisht ashtu siç ishte parashikuar, por megjithatë progresi është i vërejtshëm, dhe evidenton fakti se është mbajtur një vëllim i lart i e punës në të gjitha drejtimit për të përmbushur detyrat përkundër faktorit pandemi, zhvillimeve legislative, ristrukturimit institucional, të cilët nuk ishin në favor të klimës së trajnimit.

Programi i realizuar i trajnimit kishte një strukturë të qartë të objektivave dhe temave të trajnimit të cilat ishin të ndërlidhura me strategjitë kyçe qeveritare: Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën, Strategjinë Kombëtare për Integrimin Evropian, Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike, për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike, Strategjitë për Vetëqeverisje Lokale.

Indikatorët e planit të trajnimit e tregojnë se janë organizuar me shumë aktivitete siç ishin planifikuar dhe si në trajnime janë përfshirë të gjitha institucionet, ku shtrihet shërbimi civil Zyrat e presidentit, Kuvendit, kryeministrit dhe ministrit, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura, komunat, kompanitë publike, Sistemi i drejtësisë dhe Njësitë rajonale të cilat kanë përfituar nga trajnimet e IKAP.

Trajnimi është ofruar në formë virtuale në përqindje më të lartë se trajnimi në formë fizike siç ishte planifikuar duke ruajtur vazhdimësinë e shërbimit po edhe duke i kushtuar kujdes kualitetit të shërbimeve ndaj klientit. Indikator i cilësisë së trajnimit (në një shkallë nga 1 në 5) u arrit në shkallën 4.85. Mesatarja e pjesëmarrjes në kurse ishte 12.5 pjesëmarrës nga 20, sa është standardi me të cilin operon IKAP, ndërkohë që përfaqësimi gjinor me pjesëmarrja nga minoritetet ishte i balancuar.

Bashkëpunimi me projekte të ndryshme të financuar nga donatorët ka rezultuar pozitiv. Është rritur vëllimi i trajnimit dhe në aspektin afatgjatë është hartuar plani afatmesëm i trajnimit si një dokument që do të adresojë për trajnim për vitet 2022-2024 dhe është mbajtur një trend i mirë i aftësisë së koordinimit të aktiviteteve me donatorë që mbështetin administratën publike, duke forcuar rolin e IKAP-in, si institucion i besueshëm dhe i qëndrueshëm.

IKAP ka filluar një proces në reformim me ndikim për të ardhmen. Për ristrukturimin organizativ është hartuar rregullorja e organizmit të brendshëm, janë punuar dokumentet për reformën e trajnerëve, është punuar platforma ILAS për digjitalizim të trajnimit.

Buxheti i ndarë për IKAP dhe financimet e donatorëve janë përdorur drejtpërdrejt për zhvillimin e trajnimeve, në përputhje me nevojat e administratës publike dhe për nevojat e zhvillimit organizativ.

Me mënyrën e punës dhe me drejtimit e investimit si dhe me të arriturat në të dy prioritetet IKAP është futur në rrugën për të qenë një aktor më i fuqishëm në mbështetje të politikave institucionale dhe një institucion pararendës i promovimit të vlerave të shërbimit publik.